

VENDIM
Nr. 380, datë 2.5.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 89, DATË 16.1.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR CAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË
MASËS SË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN
RURAL PËR VITIN 2013”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4.21 të vendimit nr. 89, datë 16.1.2013 të Këshillit të Ministrave, të shtohet pika 4.22 me këtë përmbajtje:

“4.22 Kompensimi i tatimit mbi vlerën e shtuar që fermeri ka paguar në blerjen e *inputeve* bujqësore dhe kafshëve të racës, të tilla si: plehrat kimike, pesticide, farëra, fidanë frutorë, mëshqerra racë e pastër, të imëta racë e pastër, material biologjik për ndërzim, ushqime për kafshë, materiale për bletarinë, plastmasë për serra.

Kompensim i tatimit mbi vlerën e shtuar bëhet bazuar në faturën e blerjes me TVSH.

Kriteret dhe procedura e kompensimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Efektet financiare të këtij kompensimi të përballohen nga buxheti i vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha